



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.28

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Prishtinë, më 2 mars 2022, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë :** Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Miljana Nikoliq, Labinotë Demi-Murtezi, Haxhi Avdyli, Burim Meta, Mirsad Shkreta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj dhe Samra Ilijazi: anëtarë.

**Mungoi:** Floretë Zejnullahu, anëtare.

**Stafi mbështetës:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Violeta Salihu, KSHMS.

**Mbledhjen e kryesoi** Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit.

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 14.02.2022 dhe 23.02.2022;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 14.02.2022 dhe 23.02.2022;**

*Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 14. 2. dhe 23. 2.2022, u miratuan pa vërejtje.*

**Fatmire Kollçaku** tha para se të kalojmë në pikat e rendit të ditës kam për ta shprehur një reagim lidhur më vizitën që e kishte Komisioni më 23 shkurt 2022 në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, në takimin që ishte Bordin drejtues dhe drejtorin SHSKUK-së, qëllimi vizitës ishte për Listat e pritjes për operime me theks të veçantë në Kardiologji dhe Ortopedi, funksionalizimi i Spitalit të ri të Pediatriisë, si dhe furnizimi me barna nga lista esenciale. Në atë takim, dikush ka incizuar një pjesë të bisedës dhe ka shpërndarë në media. “Ka ndodhur një akt i dënueshëm sepse është bërë incizimi i takimit i paautorizuar, aty nuk ka pasur përfaqësues të mediave dhe nuk është paralajmëruar që do të bëhet incizimi i bisedave, ka qenë një bisedë, një raportim i Bordit dhe drejtorit të SHSKUK-së”. Më këto tema i që ceka dhe që ju janë dërguar drejtuesve të SHSKUK-së, në momentin që është kërkuar vizita nga ana e Komisionit dhe një pjesë e debatit është shkëputur dhe incizimi ka rrjedhur në media për këto incizim ta pa paparalajmëruar, legjislacionin që e rregullon e këtë çështje është e dënueshme.

**Mirsad Shkreta** lidhur më vizitën që ishte më drejtuesit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, tha që qëllimi i vizitës ishte për të informuar më temat që ceku kryetarja e komisionit, ku në këtë takimi i kemi shprehur shqetësimet e qytetarëve që po na adresohen çdo ditë rreth listave të pritjes për operim që janë në numër të madhe dhe këto lista e pritjes të pacienteve janë grumbulluar tani edhe që një kohë të gjatë, pastaj pyetja ishte nëse bordit i SHSKUK-së e ka miratuar organogramin e funksionimit të SHSKUK-së përgjigjja ishte jo, ndërsa pyetjet tona ishin legjitime në kuadër të përgjegjësisë që i ka Bordi drejtues dhe drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, në bazë të Ligjit për Shëndetësi që është në fuqi, ne duke i adresuar këto probleme, takimi ka përfunduar në mënyrë jo rregullt nga drejtuesja e këtij institucionin, “Kryesuesja e Bordit drejtues të SHSKUK-së na është drejtuar me fyerje, deputetëve, z. Bekim Haxhiut, mua, ‘unë juve nuk ju përfill, nuk ju njoh kush jeni’. Unë personalisht besoj që të gjithë deputetët janë të mendimit, kërkojmë nga organet kompetente, Ministria e Shëndetësisë, konform ligjit të marrë masa, masa të cilat janë obligim edhe ligjor por njëkohësisht janë edhe mandat i yni për të cilin në jemi zotuar para qytetarëve që t’i adresojmë gjitha çështjet dhe problemet e tyre.

**Fatmire Kollçaku** sqaroi se kur është dërguar kërkesa për vizitë janë cekur dhe temat që do të trajtohen në atë takim më drejtuesit e SHSKUK-së siç janë: Listat e gjata të pritjes për operime në disa klinika, funksionalizimi i Spitalit të ri të Pediatriisë, si edhe furnizimi me barna nga lista esenciale, këto ishin disa nga çështjet që u diskutuan, po ashtu janë ngritur dhe çështje tjera rreth funksionit të SHSKUK-së.

**Bekim Haxhiu** tha që është shqetësuese mënyra e sjelljes së kryesuese së bordit drejtues të SHSKUK-së që ka ndodhur në atë takim, po ashtu edhe në vizitën e kaluar para kësaj e kjo njëjta e lëshuara takimin pa ndonjë arsytim. Por ajo çka është më shqetësuese është situata e krijuar më lista e gjata të pritjes për operacione kirurgjike deri në 1 vit në klinikat kirurgjike. Këto ishin disa prej temave që i parashtrua se “Çka po ndodh me lista të pritjes. 20 mijë operacione janë më pak në SHSKUK në vitin 2021. Pra, janë 20 mijë operacione më shumë në sektorin privat. Dhe kjo ka kosto miliona euro. Dikush ka përfituar dhe prandaj ka edhe përpjekje me i ikur llogaridhënies dhe nuk ka përgjegjësi ku lista e pritjes në procedurë diagnostikuese nga 0 ditë sa ishte deri në 1 javë tani

është bërë në 6 muaj deri në 1 vit pritje”. Pyetjet ishin për bordin dhe drejtorin e SHSKUK-së Sa është në total numri i referimeve të pacientëve jashtë SHSKUK-së përgjatë viteve 2018-2021? Sa është numri i referimeve jashtë vendit të rastet e fëmijëve? Sa është lista e pritjes për procedurat diagnostikuese? Pse është inauguruar Spitali peditarik, kur nuk është bërë pranimi teknik dhe ende nuk është marrë leja për përdorim nga Komuna e Prishtinës? Kur Bordi drejtues dhe drejtori i SHSKUK-së, nuk janë në gjendje të përgjigjen në këto pyetje, atëherë për gjitha këto çështje duhet të diskutohet me ministrin e Shëndetësisë, pasi që ish ministri i MSH-së e ka propozuar këtë bord dhe Qeveria e tanishme i ka emëruar dhe kanë përgjegjës të drektë ndaj tyre. Ndërsa sa i projektligjeve, theksoi se këto kanë ardhur vetëm për t’i harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje, mirëpo gjatë shqyrtimit i kemi vërejtur se MSH-ja si sponsore e këtyre projektligjeve ka ndërhyrë në strukturën dhe përmbajtjen e ligjeve bazike, andaj duhet t’ia kthej MSH-së, sepse disa prej këtyre projektligjeve në bazë të Programit Legjislativ të Qeveris për vitin 2022, pritet të vijën përsëri këtë vit dhe mos të bëjmë punë të dyfishtë, duke i shqyrtuar disa herë më të njëjtën përmbajtje të strukturës.

**Fatmire Kollçaku** sqaroi për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor, që do të shqyrtohen përsëri në Komision ku do të ftohen dhe përfaqësuesit e MSH-së për t’i arsyetuar këto dy projektligje.

**Armend Zemaj** tha se listat e pritjes për operim në disa Klinika janë të mëdha, ka qenë një arsye për pandemia, si duket ka krijuar një komoditet dhe tash ka kaluar në nivel të degradimit, sidomos lista e pritjes në ortopedi, radiologji, kardiologji janë shndërruar në luks, e jo në ofrim të shërbimeve ndaj pacienteve, andaj faji është i Bordit të SHSKUK-së, për mos menaxhim të mirë më këto lista, dhe askush nuk ka dhënë përgjegjësi, pse është lejuar rritje kaq madhe këtyre listave për mos ofrim të shërbimeve mjekësore. Ai theksoi se skandali më i madh është që “Kryesuesja e bordit të SHSKUK-së, është në të njëjtën kohë edhe kryesuese e komisionit për zgjedhjen e drejtoreshave të klinikave, dmth. hierarkia më e lartë e cila propozohet nga ministri i shëndetësisë dhe miratohet nga Qeveria është emërim politik, edhe kjo është në kundërshtim me krejt normat ligjore që janë dhe këtu dikush duhet të vihet para përgjegjësisë për këtë skandal”. Ai tha kur të shkoni në SHSKUK dhe në emergjencë e keni kaos, sepse SHSKUK-ja drejtohet nga Bordi drejtues dhe është organi më i lartë vendim-marrës i SHSKUK-së në bazë të Ligjit për Shëndetësi, andaj këta e kanë krijuar kaos aty jo për faj të mjekëve, por për shkak të papërgjegjësisë së kryesueses të bordit dhe ekipit të saj, andaj të merren masa për këto parregullsi duke e kërkuar edhe shkarkimin e Bordit të SHSKUK-së. Sa i përket projektligjeve, tha se është, por për të shkuar në seancën e Kuvendit, ndërsa gjatë këtij viti presim nga Qeveria sjelljen e projektligjeve për Shëndetësi dhe për Sigurimet Shëndetësore dhe te projektligji për shëndetësi të rregullohen këto probleme më emërimin e Bordit të SHSKUK-së dhe për zgjedhjen e drejtoreshave të klinikave.

**Burim Meta** tha që ne, si Komision, kemi qenë kompakt për të mirën e përgjithshme të funksionimit të sistemit shëndetësor, por që ngecjet po na paraqiten te disa institucione shëndetësore që duhet t’ju kryhen shërbime pacienteve. Për listat e pritjes, tha që duhet ta kërkojmë shkakun pse është krijuar ky numër kaq i madh, a ka qenë pandemia COVID-19, shkaktar, ndërsa asnjë arsye tjetër nuk duhet të arsyetohet. Lidhur më atë që ka ndodhur në vizitën që ishte Komisioni në SHSKUK-së ka thënë se është për keqardhje kur anëtarët e komisionit kishin paraqitur disa pyetje kurciale që janë në funksionim të SHSKUK-së, dhe takimi devijon më akuza të paqena, nga kryesuesja e Bordit të SHSKUK-së, drejtuar anëtarëve të komisionit se janë deputetet që po inteferojnë në zgjedhjen e drejtoreshave të klinikave, kjo është e pa vërtet dhe duhet të demantohet. Ndërsa sa i përket projektligjeve tha që pajtohet që të miratohen për procedim në seancën e Kuvendit.

**Shemsedin Dreshaj** tha që Komisioni ka punuar dhe është duke punuar pa dallim pozite dhe opozite, por që fatkeqësisht Qeveria e Kosovës, edhe pse shumë herë e kishte proklamuar së shëndetësia do të është prioriteti i tyre, por që në realitet nuk po ndodh. Ai thënë së kemi problem të përditshme në shëndetësinë e vendit siç janë: Procedurat diagnostikuese për pacientet, që duhet ta presin rezultatin, kjo gjë nuk duhet të ndodh, kjo dukur duhet eliminohet që rezultati pacienteve të ju jepet së më shpejt që është mundshme jo të presin për një kohe të gjatë, listat kaq të mëdha për operime duhet të përshpejtohen, organizohen ekipet mekjeve në bazë të rasteve që janë më keq të fillojnë operacionet, dhe edukimi specialistikë është në piken më të ulët, andaj lihet hapësirë më madhe specializanteve për edukim. Ai potencoi së mos miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Shëndetësi, po shkakton shumë problem në mos funksionimin SHSKUK-së, andaj përgjegjësit duhet të ndahen më anë të këtij ligji më dhe organizmi i SHSKUK-së duhet të bëhet më miratimin e organo-gramit të ri, duhet konstatuar ku është pengesa, pse një situatë e këtillë është në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, a është problemi tek organizimi i shërbimit klinik universitar apo është problemi të personat të cilët janë të nominuar për t'i menaxhuar këto institucione, prandaj MSH, këtë situatë të krijuar rreth përgjegjësive të menaxhimit në mes të SHSKUK-së dhe QKUK-së duhet ta qartësojë dhe ta zgjedhë këtë problem të funksionit të këtyre institucioneve shëndetësore, më anë të miratimit të Ligjit të ri për shëndetësi. Ndërsa sa i përket këtyre projektligjeve, tha që duhet të ceket së miratimi i tyre ka bërë vetëm më harmonizimin e Ligjit për Kundërvajtje, ku rregullohen dispozita ndëshkues më gjoba, jo më përmbajtjeje të ligjeve në tersi.

**Haxhi Avdyli** tha që pajtohet më koleget që gjitha këto tema për çështje më problem e sfida nëpër institucione shëndetësore që të na shërbejnë për reforma në sistemin shëndetësor të vendit. Projektligjet, që janë sot në rendin e ditës, tha së duhet të miratohen, është një kohë gjatë që janë komision, pasi që janë vetëm për harmonizim më Ligjin për Kundërvajtje, atëherë të procedoheni për procedurat e mëtutjeshme. Ajo çka është më rëndësi, lidhur më agjendën legjislativë të qeverisë për vitin 2022, për projektligjet bazike që janë në funksionim të shëndetësisë që parashihen të vijnë në vjeshtë, duhet të kërkohet nga MSH-ja përshpejtimi i tyre. Sa i përket bordit të SHSKUK-së “I bëj thirrje kryeministrit dhe ministrit të Shëndetësisë, që ta shkarkojë këtë bord të SHSKUK-së, për të cilët të gjithë deputetët kanë vërejtje. Dhe të emërohet një bord tjetër dhe të merret një përgjegjësi”. Ne jemi zëri i qytetarëve dhe ne duhet t'i adresojmë shqetësimet dhe duhet t'i monitorojmë ata. Ne, si një institucion, që jemi të zgjedhur nga qytetarët dhe nëse ne nuk i adresojmë këto kërkesa të qytetarëve atëherë ne nuk jemi në krye të detyrës”. Lidhur më listat e pritjes për operim jemi të vetëdijshëm që ka pas pandemi këto dy vite dhe rastet që presin janë shtyrë, por pritjet për rezonancë nuk arsyetohen, andaj duhet të ketë veprime konkret nga gjithë menaxhmenti i SHSKUK-së, po ashtu dhe nga drejtoret e klinikave përkatëse që të përshpejtohen këto rast.

**Labinoçi Demi-Murtezi** sa i përket takimit që ishte më drejtuesit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, tha ne, si anëtarë të Komisionit funksional që mbikëqyrim punën e institucioneve shëndetësore, pos temave që ishin caktuar para vizitës aty kemi ngritur shumë çështje dhe problem të qytetarëve që ballafaqohen çdo ditë më marrjen e shërbimeve mjekësore. Gjatë takimit ajo që ishte ofendues për Komisionin nga kryesuesja e bordit të SHSKUK-së ishte lëshimi i takimit nga ana e saj që është hera e dytë si nikoqire e takimit që lëshon takimin, fatkeqësisht në këtë vizitë edhe pse kemi shkuar për t' u informuar për së afërmi më sfidat dhe problemet e këtij institucion, nga ky takim nuk kemi marrë informata për shumë çështje që kemi pyetur. Ai tha që kanë kërkuar sqarim për mos pajisjen më Rezonanca Magnetike të spitaleve rajonale, kur këto operatura janë shumë të mundshme të blihen në mënyrë që mos të ketë listë kaq të gjatë pritjes në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, dhe më blerjen e këtyre rezonancave magnetike për

spitalet rajonale, nuk krijohen lista e pritjes në QKUK, po ashtu qytetarët këto shërbim i kryejnë në vendet e afërta të tyre nga janë dhe nuk shpenzojnë parë për të ardhur në Prishtinë. Propozoi që komisioni ta shqyrtojë raportin e auditimit për vitin 2020 të SHSKUK-së dhe të ftohet Bordit i SHSKUK-së për të raportuar lidhur më të gjeturat e Auditori të Përgjithshëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Mirsad Shkreta** tha pas këtyre akuzave të pa baza që na ka bërë kryesuesja e bordit të SHSKUK-së, ne, deputetët, kinse po inteferojmë në zgjedhjen e drejtove të klinikave, dhe kemi interes në zgjedhjen e drejtove të këtyre klinikave, atëherë e ftojë ministrin e shëndetësisë që në bazë të Ligjit për Shëndetësi, pasi që Bordi drejtues i SHSKUK-së i përgjigjet Qeverisë nëpërmjet MSH-së, atëherë ne, deputetët e Kuvendit, e kemi zgjedhur qeverinë dhe ne, si Komision Funkcional si nuk kemi të drejtë të kërkojmë informata për çështje të caktuar për funksionimin e këtij institucion. Andaj kërkoi nga MSH-ja që të na njoftojë se a është duke respektuar ligjshmërinë SHSKUK-ja në raport më çështjet që i ka ngritur komision, këto janë fakte evidente dhe ne duhet të kërkojmë nga çdo institucion së a po zbatohet ligjshmëria dhe transparenca, po ashtu duhet të marrim përgjigje nga MSH-ja lidhur edhe më raportin e auditimit për vitin 2020 të SHSKUK-së.

**Fatmire Kollçaku** kërkoi nga anëtarët e komisionit që këto ankesa t'i parashtrajnë para ministrit të Shëndetësisë, z. Rifat Latifi, që është i ftuar për të raportuar në mbledhjen që është planifikuar të mbahet ditën e mërkurë më 9.03. 2022, në mënyrë që të marrin përgjigje, për shumë çështjet të adresuar për rolin mbikëqyrës të Ministrisë në raport me SHSKUK –në dhe për Strategjinë Legjislative të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022.

**Fatmire Kollçaku** tha se tani po e vazhdojmë mbledhjen më pikat e rendit të ditës ku kemi 5 projektligjet që janë sjellë nga Qeveria, konkretisht nga Ministra e Shëndetësisë, që të gjitha këto projektligje kanë ardhur vetëm për t'i harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje, që i përkasin fushës së shëndetësisë. Ajo propozoi që të miratohen këto 5 projektligje, ndërsa për 2 projektligjet e tjera që mbesin, siç janë: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor, tha që do të kërkojmë sqarime shtesë nga MSH-ja, pastaj komision do të marrë një vendim për to. Ajo tha se edhe pse është punuar shumë në këto projektligje prapëseprapë mendoj se duhet të procedohen ashtu siç kanë ardhur prej Ministrisë së Shëndetësisë pa amendamente, pasi që kështu na është kërkuar nga ministra, për mos më bërë amendamente në nenet e këtyre projektligjeve, sepse mund të ketë problem, në zbatim e tyre. Propozoi që t'i miratojmë si të tilla dhe këto raport do t'u dërgohen komisioneve kryesore për t'i shqyrtuar Projektligjet, andaj këto raporte do të jenë përfundimtar lidhur me këto Projektligje, pasi të jepen edhe rekomandimet eventuale nga komisionet kryesore. Pastaj i hodhi në votim një nga një 5 projektligjet si vijim:

### **3.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi**

*Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim nxori këtë:*

#### *Përfundim*

- 1.Miratohet Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi;*
- 2. Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, procedohet në komisionet kryesore për vlerësim, sipas kompetencës.*

#### **4.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor**

*Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim nxori këtë:*

##### *Përfundim*

*1. Miratohet Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor;*

*2. Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, procedohet në komisionet kryesore për vlerësim, sipas kompetencës.*

#### **5.Shqyrtimi i Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike**

*Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim nxori këtë:*

##### *Përfundim*

*1. Miratohet Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike;*

*2. Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike, procedohet në komisionet kryesore për vlerësim, sipas kompetencës.*

#### **6.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale**

*Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim nxori këtë:*

##### *Përfundim*

*1. Miratohet Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale;*

*2. Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligji nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, procedohet në komisionet kryesore për vlerësim, sipas kompetencës.*

#### **7.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse**

*Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim nxori këtë:*

##### *Përfundim*

*1.Miratohet Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse;*

*2. Raporti i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, procedohet në komisionet kryesore për vlerësim, sipas kompetencës.*

## **8.Të ndryshme**

Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

**Fatmire Kollçaku,**  
-----  
**Kryetare e Komisionit**